



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 dhjetor 2021
Nr.ref.:RK 1931/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI123/20

Parashtrues

S. K.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [Rev.
nr. 390/2018], të 4 dhjetorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga S. K., me adresë të përhershme në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [Rev. nr. 390/2018], të 4 dhjetorit 2019.
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 8 qershor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 10 gusht 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 26 gusht 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 31 gusht 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kësaj kërkesë iu dërgua Gjykatës Supreme të Kosovës.
9. Më 31 gusht 2020, Gjykata njoftoi për regjistrimin e kërkesës Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) dhe kërkoi nga ajo dorëzimin e fletëkthesës që dëshmon se kur parashtruesi e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.
10. Më 10 shtator 2020, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se parashtruesi i kërkesës aktgjykimin e kontestuar e kishte pranuar më 8 qershor 2020.
11. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u

zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës, [KK-SP 71-2/21], të 17 majit 2021, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

12. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
13. Më 27 maj 2021, Gjykata kërkoi dosjen e plotë të rastit të parashtruesit të kërkesës nga Gjykata Themelore në Prishtinë.
14. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP-71-2/21], gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani, nxori Vendimin [Nr. KSH. KI123/20] duke e zëvendësuar Kryetaren paraprake, Arta Rama-Harizi, në rolin e saj si kryesuese në Kolegjin shqyrtues.
16. Më 31 maj 2021, Gjykata pranoi dosjen e plotë nga Gjykata Themelore në Prishtinë.
17. Më 10 dhjetor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

18. Në rrethanat e rastit konkret janë zhvilluar dy grupe procedurash pranë gjykatave të rregullta: 1) procedura për alimentacion; dhe 2) procedura për vërtetimin e atësisë.

Procedura për alimentacion

19. Palë në këtë procedurë paraqiten prindërit e fëmijës D. K., respektivisht nëna e tij T. V., në cilësinë e iniciueses se kësaj procedure dhe babai F. K.
20. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 445/2009] të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 28 majit 2010, është zgjidhur martesë me marrëveshje në mes T. V. dhe F. K., dhe është vendosur që fëmija i mitur D. K., të jetë nën përkujdesjen e nënës, përkatësisht T. V., ndërsa F. K., respektivisht babai i fëmijës së mitur D. K., është detyruar që të paguaj shumën prej 100 euro në muaj në emër të alimentacionit, duke filluar nga 1 qershori 2010 e derisa të ekzistojnë kushtet e parapara ligjore për pagesë.

21. I padituri F. K. kishte paraqitur ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur në Gjykatën Supreme të Kosovës.
22. Më 7 shtator 2010, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 62/2010] refuzoi ankesën e të paditurit F. K., si të pabazuar, por ndryshoi aktgjykimin e lartcekur dhe vendosi që F. K. të paguaj vetëm 60 euro në muaj, duke filluar nga 1 qershori 2010 e derisa të ekzistojnë kushtet e parapara ligjore për pagesë.
23. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se ekzekutimi i aktgjykimit të lartcekur nuk ka qenë i mundur duke u bazuar në konstatimin se F. K., nuk kishte mjete për pagesë.
24. Si rezultat i kësaj, paditësja T. V. më 7 shtator 2010 kishte parashtruar padi kundër F. K., duke kërkuar ndryshimin e vendimit, përkatësisht që të detyrohet i padituri të paguaj në emër të alimentacionit kërkesa të veçanta në baza vjetore: për veshmbathje 500 euro, për edukim 1500 euro, ndërsa për strehim për çdo muaj në shumën prej 150 euro. Gjithashtu, paditësja T. V. kërkoj kompensim për dhimbje shpirtërore në shumë prej 150 euro me një kamatë prej 3.5 %.
25. Më 28 prill 2016, paditësja T. V. zgjeroi padinë edhe ndaj parashtruesit të kërkesës, S. K., dhe kërkoj që parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e gjyshit të paguaj alimentacion për fëmijën D. K., në përputhje me nenin 282 të Ligjit për familjen, në shumë prej 180 euro dhe 150,000.00 euro për dëmin jomaterial. Po ashtu, i ka propozuar gjykatës të detyrohen të paditurit S. K. dhe F.K., që shumat e kërkuara të paguhen nga të ardhurat e S. K., respektivisht nga pasuria e tij e paluajtshme. Më tutje është kërkuar kompensimi në mënyrë solidare nga dy të paditurit në raport me paditësen për shpërblim të dëmit jomaterial, pasi që i padituri i dytë si baba i të paditurit *“ka dërguar shkues për fejesë të paditëses duke e fshehur sëmundjen e djalit të tij”*.
26. Në këtë padi, paditësja T. V. ka theksuar se duke pasur parasysh faktin se i padituri F. K. nuk e ka përmbushur asnjëherë detyrimin për D. K., kërkoj që të paditurit F. K. dhe parashtruesi i kërkesës S. K., në cilësinë e gjyshit të kontribuojnë në mbajtjen e fëmijës.
27. Më 16 dhjetor 2016, Gjykata Themelore duke iu përgjigjur padisë së paraqitur nga T. V., nxori Aktgjykimin [C. nr. 1920/10], përmes të cilit ndryshoi pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit [Ac. nr. 62/2010] të 7 shtatorit 2010, të Gjykatës Supreme dhe më tutje detyroi F. K., në cilësinë e prindit të fëmijës D. K., të paguaj shumën prej 40 euro në muaj dhe parashtruesin e kërkesës S. K., në cilësinë e gjyshit të fëmijës D. K., të paguaj shumën prej 60 euro në muaj në emër të ushqimit-alimentacionit për fëmijën e mitur D.K.
28. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës S. K. dhe F. K. u ankuan në Gjykatën e Apelit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, , duke propozuar që aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

29. Më 5 korrik 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 4454/17] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, ndërsa aprovoi pjesërisht ankesën e paditëses T. V. dhe ndryshoi vetëm pikën I (një) të dispozitivit që ka të bëjë me pagimin e alimentacionit, dhe vendosi që të paditurit F. K. dhe parashtruesi i kërkesës në mënyrë solidare të paguaj shumën prej 120 euro në muaj në emër të ushqimit-alimentacionit për fëmijën e mitur D. K.
30. Kundër aktgjykimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës dhe pala relevante në raste paraqitën revizion në Gjykatën Supreme me pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimi i lartcekur të ndryshohet dhe lënda të kthehet në rivendosje në shkallën e parë.
31. Më 4 dhjetor 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 390/2018] refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [Ac. nr. 4454/17] e 5 korrikut 2018, të Gjykatës se Apelit.

Procedura lidhur me vërtetimin e atësisë

32. Palë në këtë procedurë paraqitet F. K. në cilësinë e paditësit pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë.
33. Nga shkresat e lëndës rezulton se i biri F. K. i parashtruesit të kërkesës S. K., kishte qenë në marrëdhënie martesore me T.V. dhe gjatë kësaj periudhe ka lindur fëmija D. K. Pas një kohe, kishin lindur dyshime nga F. K. lidhur me atësinë e fëmijës D. K.
34. Më 5 nëntor 2012, F. K. kishte ushtruar padi për vërtetimin e atësisë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar që të miratohet kërkesëpadia e tij dhe propozimi që të merren provat përmes analizës gjenetike të ADN-së dhe të vërtetohet se F.K., nuk është babai biologjik i të miturit D.K.
35. Në zhvillimin e kësaj procedure, e paditura T. V. kishte theksuar se paditësi F. K., është babai biologjik i fëmijës D. K., por sipas saj qëllimi i kësaj padie është që paditësi të heq barrën e mbajtjes për fëmijën e tyre.
36. Më 24 nëntor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktvendimit [C. nr. 894/17], refuzoi ankesën e paraqitur si të paafatshme, me arsyetimin se padia ishte paraqitur më 5 nëntor 2012, ndërsa paditësi ka kuptuar rrethanat lidhur me atësinë e fëmijës qysh në vitin 2007, pra sipas Gjykatës Themelore padia është ushtruar 5 vite pasi që ka kuptuar për rrethanën e cila do t'i jepte shkak për ushtrimin e padisë.
37. Në një datë të paspecifikuar, pala paditëse F. K. ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

38. Më 2 mars 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 271/2018] shpalli të pavlefshme Aktvendimin [C. nr. 894/2017] të Gjykatës Themelore dhe rastin e ktheu në rigjykim në Gjykatën Themelore me arsyetimin se paditësi ka zënë afatin objektiv të paraparë me nenin 113 të LFK-së.
39. Ndër të tjera, Gjykata e Apelit theksoi: *“Në rishqyrtimin e çështjes, gjykata e shkallës së parë, është detyruar që të veproj sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna nga kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, duke vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike lidhur me çështjen konkrete juridike e cila ka të bëjë me vërtetimin e atësisë së paditësit për djalën D.K., duke përfillur propozimin e tij për nxjerrjen e provës së ADN-së [...] mbi të cilin duhet të zbatohet drejtë edhe e drejta materiale, gjë që në fund duhet të rezultojë me vendim të drejtë dhe të ligjshëm”.*
40. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vëren se çështja për vërtetimin e atësisë është dërguar në Gjykatën Themelore dhe se as nga dosja e lëndës por as nga vetë parashtruesi i kërkesës, Gjykata nuk është njoftuar për statusin e kësaj çështjeje, përkatësisht nuk ka njohuri nëse Gjykata Themelore ka nxjerrë ndonjë vendim për këtë çështje apo nëse e njëjta është apeluar në një instancë më të lartë gjyqësore.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës

[...]

Neni 278. Parimi

- (1) *Mbajtja financiare në kuptimin e këtij Ligji nënkupton detyrimin financiar dhe material.*
- (2) *Të afërmit në vijë të drejtë janë të detyruar të sigurojnë mbajtje financiare reciproke.*

Neni 283. Ndryshimi i radhës së detyrimit

- (1) *Derisa i afërmi nuk është i detyruar të jap mbajtje financiare, detyrimi kalon në të afërmit e radhës në bazë të radhës së pastajme të detyrimit*
- (2) *Përgjegjësia e bashkëshortit për t'i dhënë mbajtje financiare bashkëshortit të tij kalon në të afërmit e personit që ka nevojë vetëm në rastet e pamundësisë financiare siç është cekur në nenin 280 (1).*

Neni 284.

Rregulla e ndarjes së detyrimit të më shumë personave për dhënien e mbajtjes financiare

Në rast se më shumë se një person ka nevojë dhe personi që ka detyrim të sigurojë mbajtje financiare për të gjithë nuk është në gjendje të ofrojë mbajtje të plotë nën arsyet e cekura në nenin 280, detyrimi ndahet mes të gjithë të afërmeve që janë të detyruar derisa mbajtja financiare të jetë garantuar plotësisht.

Neni 331.

Përshtatja e vendimeve për mbajtje

(1) gjykata me kërkesën e paditësve apo personave të detyruar mund të ndryshoj vendimin ashtu që të ndërprej të shtoj, të zvogëlojë mbajtjen financiare ose alimentacionin i cili është përcaktuar me anë të vendimit të mëparshëm gjyqësor nëse rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimi kanë ndryshuar.

(2) Kushtet të cilat mund të ndryshojnë janë nevoja personale dhe rritje e shpenzimeve të jetesës në anë të kërkuarit si dhe statusit financiar të të pandehurit në anën tjetër.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

41. Gjkata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], dhe 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
42. Parashtruesi i kërkesës pohon si në vijim: “Kërkoj nga Gjykata Kushtetuese t’i evidentojë shkeljet e cekura në aktgjykimet paraprake dhe të aprovoj kërkesën time, sepse konsideroj se, gjykatat më të larta në vend në këtë çështje kanë nxjerrë vendim në kundërshtim me të drejtën për arsye se, ne si palë dhe avokatët në këtë procedurë e veçanërisht gjykata në këtë çështje kontestimore edhe pse kanë qenë në dijeni dhe më kanë mohuar të drejtën për vërtetimin e atësisë në këtë çështje kontestimore”.
43. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson: “Gjykata është dashur të veproj fillimisht të marr parasysh se, aktgjykimet paraprake janë të pabaza, nuk është dhënë interesi i ndërgjyqësve, por, edhe interesi i fëmijës së mitur i cili mbrohet me Kushtetutë dhe Konventa Evropiane, Gjykata është dashur që të eliminojë mundësinë e paraqitjes së pasojave të padëshirueshme më vonë që në mënyrë të padyshimtë të dihet se është apo nuk është babai biologjik i fëmijës D. K”.
44. Më tutje, parashtruesi i kërkesës thekson si në vijim: “Gjykata paraprake është dashur të lëshohet në vendosje meritore të çështjes duke i përfillur propozimet e tyre për nxjerrjen e provave me qëllim të vërtetimit të fakteve vendimtare që ndërlidhen në vërtetimin e atësisë së paditësit F. K. duke vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike lidhur me çështjen konkrete juridike e cila ka të bëjë me vërtetimin e atësisë së paditësit për djalin D.K., duke përfillur propozimin e tij për nxjerrjen e provës së ADN-së (Akronim për acidin desoksiribonukleik, si substancë në të cilën mbartet i koduar informacioni i

trashëgimisë), mbi të cilën duhet të zbatohet drejtë edhe e drejta materiale, gjë që në fund duhet të rezultojë me vendim të drejtë dhe të ligjshëm”.

45. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

46. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

48. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

49. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke e kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin

[Rev. nr. 390/2018] e 4 dhjetorit 2019, të Gjykatës Supreme pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

50. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikisht përcakton që:

Rregulli 39 (Kriteret e pranueshmërisë)

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

51. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
52. Në këtë kontekst, dhe në vijim, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në rrethanat e këtij rasti, vlerësimit nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë rrethanat e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

(i) Procedura për alimentacion

53. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se gjykatat e rregullta në përcaktimin e detyrimit financiar ndaj parashtruesit të kërkesës për mbajtjen e nipit të tij D. K., përmes vendimeve të nxjerra kanë shkaktuar shkelje të të drejtave të tij kushtetuese të garantuara me nenet 23, 24 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
54. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës si pjesëtar i familjes pretendon se gjykatat e rregullta fillimisht do të duhej që të vërtetonin atësinë e fëmijës përmes analizës së ADN-së në mënyrë që të vërtetoj drejt gjendjen faktike dhe në fund të vendosë lidhur me çështjen e alimentacionit.

55. Gjykata rikujton se vendimi i parë lidhur me procedurën e alimentacionit në të cilin ishte vendosur fillimisht detyrimi financiar ndaj parashtruesit të kërkesës në cilësinë e gjyshit për mbajtje të fëmijës D. K. ishte përmes Aktgjykimit [C. nr. 1920/10] të Gjykatës Themelore, i cili ndryshoi Aktgjykimin [Ac. nr. 62/2010] e 7 shtatorit 2010, të Gjykatës Supreme, ku detyroi F. K., në cilësinë e prindit të fëmijës D. K., të paguaj shumën prej 60 euro në muaj dhe në fund detyroi po ashtu parashtruesin e kërkesës në cilësinë e gjyshit të fëmijës të paguaj shumën prej 40 euro në muaj në emër të ushqimit-alimentacionit për fëmijën e mitur.
56. Ne këtë drejtim, Gjykata vëren se prindi i fëmijës F. K. kishte dështuar që të paguaj alimentacionin ashtu siç ishte përcaktuar fillimisht përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 445/2009] të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 28 majit 2010 dhe më pas përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 62/2010] të Gjykatës Supreme të 7 shtatorit 2010, me arsyetimin se nuk kishte mjete financiare.
57. Gjykata vëren se pas inicimit të ankesës nga ana e parashtruesit të kërkesës dhe F. K., Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte ndryshuar nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 4454/17] në pikën I (një) të dispozitivit që ka të bëjë me pagimin e alimentacionit, duke vendosur që i padituri F. K. dhe parashtruesi i kërkesës në mënyrë solidarë të paguaj shumën prej 120 euro në muaj në emër të ushqimit-alimentacionit për fëmijën e mitur D. K.
58. Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 4454/17] kishte arsyetuar se:

“Gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike po mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar nuk ka zbatuar drejt dispozitat materiale që rregullojnë çështjen e detyrimit në pagimin e alimentacionit. Gjykata ka detyruar të dy të paditurit (babai dhe gjyshi) duke ndarë shumat për secilin veç e veç, mirëpo kur marrim për bazë rrethanat e rastit, referencën në nenin 290 të LFK-së, i cili përcakton detyrimin e prindërve për mbajtje financiare të fëmijëve të tyre të mitur dhe mundësinë e kalimit të këtij detyrimi tek gjyshi sipas nenit 282 të LFK-së, atëherë rezulton se nuk mund të përjashtohet prindi nga një detyrim i tillë por mbi bazën e interpretimit të këtyre dispozitave është vlerësuar si më e drejtë që babai dhe gjyshi të detyrohen në mënyrë solidarë në përmbushjen e obligimit në pagimin e alimentacionit. Detyrimi i përmbushjes solidare në këtë është më i përshtatshëm ngase nëse ekzistojnë rrethana të tilla që e bëjnë të pamundur përmbushjen e këtij detyrimi nga prindi kjo kalon tek gjyshi, mirëpo në asnjë rrethanë fëmija nuk mund të mbetet pa mbajtje financiare, që njëherit ky edhe është qëllim i përcaktimit të radhëve të personave të detyruar në dhënien e mbajtjes financiare (neni 285 I LFK-së).

59. Gjykata vëren se pas kundërshtimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme nga ana e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 390/2018] të 4 dhjetorit 2019 refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe në fund konfirmoj detyrimin financiar të parashtruesit të kërkesës për mbajtjen financiare të fëmijës D. K., duke u bazuar kryesisht në nenin 278 të LFK-së.

60. Në këtë kontekst, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 390/2018] të 4 dhjetorit 2019, ndër të tjera kishte theksuar:

"[...] Neni 278 të këtij Ligji përcakton se të afërmit, në vij të drejtë janë të detyruar të sigurojnë mbajtjen financiare reciproke si dhe parimet për mbajtjen financiare. Në rastin konkret, i padituri S.K., si gjysh është i detyruar të sigurojnë mbajtjen për nipin e tij të mitur, nëse sipas radhës së trashëgimisë, djali i tij F.K., nuk është në gjendje të përmbush obligimin ligjor".

61. Gjykata vëren se të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta adresuan pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe shpjeguan se përse iu refuzua ankesa e parashtruesit të kërkesës dhe përse iu është konfirmuar detyrimi financiar për mbajtjen e fëmijës D. K.
62. Gjykata rikujton se neni 287 i LFK-së, përcakton se *"Të afërmit në vijë të drejtë janë të detyruar të sigurojnë mbajtje financiare reciproke"*.
63. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në thelb kundërshton pagesën e alimentacionit duke argumentuar se vendimet e nxjerra lidhur me detyrimin e alimentacionit janë nxjerrë pa vërtetuar drejt gjendjen faktike lidhur me atësinë fëmijës D. K. përmes analizës gjenetike të ADN-së.
64. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se vendimi i parë, ku ishte vendosur lidhur me çështjen e alimentacionit mes prindërve të fëmijëve ishte përcaktuar përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 445/2009] të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 28 majit 2010, ndërsa padia për vërtetimin e atësisë bashkë me propozimin për analizë gjenetike të ADN-së, ishte iniciuar nga i biri i parashtruesit të kërkesës në procedurë të veçantë pranë Gjykatës Themelore më 5 nëntor 2012.
65. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e së drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë Ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-se *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih gjithashtu rastet KI128/18, parashtrues: *Limak Kosovo International Airport J.S.C.*, "Adem Jashari", Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57).
66. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu vëren që procedurat para Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore nuk ishin të padrejta apo arbitrare. (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Shub kundër Lituanisë*, kërkesa nr. 17064/06, Vendimi i 30 qershorit 2009).

67. Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore e tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë. (Shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44; shih rastet e bashkuara KI150/15, KI161/15, KI162/15, KI14/16, KI19/16, KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjokaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
68. Gjykata rikujton se e drejta për një "proces të drejtë" në procedurat civile, e cila kërkohet nga neni 6 i KEDNJ-së, nuk është drejtësi "materiale" por është drejtësi "procedurale". Në aspektin praktik kjo nënkupton se palët e kanë të drejtën për një procedurë kontradiktore në të cilën merren parasysh parashtruesat e palëve dhe në të cilën palët janë të vendosura në pozitë të barabartë para gjykatës (shih, në këtë aspekt, rastet e Gjykatës: nr. KI42/16 parashtrues *Valdet Suta*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 55).
69. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si pasojë e aplikimit dhe interpretimit të gabuar të dispozitave të ligjit të aplikueshëm, përkatësisht nenin 212.2 dhe 30.2 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore me rastin e refuzimit të revizionit, janë gjithashtu qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, si pretendime të "shkallës së katërt".
70. Gjykata, në fund, rikujton se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendime të argumentueshme për shkeljen e të drejtave kushtetuese. (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
71. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mos vërtetimit të drejt të gjendjes faktike lidhur me vendosjen e çështjes së alimentacionit, refuzohen si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Procedura lidhur me vërtetimin e atësisë

72. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ankohet lidhur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta, të cilat përcaktuan detyrimin financiar të parashtruesit për alimentacionin ndaj fëmijës D. K., me arsyetimin se në

nxjerrjen e tyre nuk është vërtetuar fillimisht atësia e fëmijës përmes analizës gjenetike të ADN-së.

73. Gjykata vëren se lidhur me vërtetimin e atësisë, i biri i parashtruesit të kërkesës, F. K., më 5 nëntor 2012, kishte ushtruar padi për vërtetimin e atësisë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar që të miratohet kërkesë-padia e tij dhe propozimi që të merren provat përmes analizës gjenetike të ADN-së dhe të vërtetohet se paditësi F. K. nuk është babai biologjik i të miturit D. K.
74. Gjykata vëren se në këtë procedurë, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte nxjerrë Aktvendimin [C. nr. 894/17] e 24 nëntorit 2017, ku kishte refuzuar ankesën e paraqitur si të paafatshme me arsyetimin se padia ishte paraqitur më 5 nëntor 2012, ndërsa paditësi ka kuptuar rrethanat lidhur me atësinë e fëmijës qysh në vitin 2007, pra sipas Gjykatës Themelore padia është ushtruar 5 vite pasi që ka kuptuar për rrethanën e cila do t'i jepte shkak për ushtrimin e padisë.
75. Gjykata po ashtu vëren se pas ankesës, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 271/2018] shpalli të pavlefshëm Aktvendimin [C. nr. 894/2017] të Gjykatës Themelore dhe rastin e ktheu në rigjykim në Gjykatën Themelore me arsyetimin se paditësi ka zënë afatin objektiv të paraparë me nenin 113 të LFK-së.
76. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vëren se çështja për vërtetimin e atësisë është dërguar në Gjykatën Themelore dhe se as nga dosja e lëndës por as nga vetë parashtruesi i kërkesës, Gjykata nuk është njoftuar për statusin e kësaj çështjeje, përkatësisht nuk ka njohuri nëse Gjykata Themelore ka nxjerrë ndonjë vendim për këtë çështje apo nëse e njëjta është apeluar në një instancë më të lartë gjyqësore.
77. Gjykata tashmë ka përcaktuar në jurisprudencën e saj se nëse procedurat janë në zhvillim e sipër tek gjykatat e rregullta atëherë kërkesa e parashtruesve konsiderohet e parakohshme. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës, KI23/10, parashtrues *Jovica Gadzic*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 shtatorit 2013; KI32/11, parashtrues *Lulzim Ramaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 prillit 2012; KI113/12, parashtrues *Haki Gjocaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 janarit 2013, paragrafi 34; KI114/12, parashtrues *Kastriot Hasi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 prillit 2013, paragrafi 33; KI07/13, parashtrues *Ibish Kastrati*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 korrikut 2013, paragrafët 28-29; KI58/13, parashtrues *Sadik Bislimi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 nëntorit 2013, paragrafi 31; dhe KI102/16, parashtrues *Shefqet Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 marsit 2017, paragrafi 39).
78. Rrjedhimisht, në rrethanat e rastit konkret, bazuar në parimin e subsidiaritetit, Gjykata është e detyruar që kërkesën e parashtruesit të kërkesës ta deklarojë si të papranueshme për shkak se është e parakohshme, duke u ofruar në këtë mënyrë mundësinë dhe përparësinë gjykatave të rregullta që t'i trajtojnë çështjet që ngritën në kërkesën e tij.

79. Deklarimi i këtij pretendimi lidhur me vërtetimin e atësisë si të parakohshme në vetvete nënkupton që parashtruesi i kërkesës e ka të garantuar me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës mundësinë që t'i drejtohet sërish kësaj Gjykate me kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimeve të autoriteteve publike, qoftë të veprimeve apo mosveprimeve të tyre, e të cilat ai mund të pretendon se konsistojnë në shkelje të ndonjë të drejte apo lirie themelore të garantuar me Kushtetutë, KEDNJ apo instrumente të tjera ndërkombëtare.
80. Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka plotësuar kriterin e pranueshmërisë së shterimit të mjeteve juridike të përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, dhe rrjedhimisht pretendimi i tij lidhur me vërtetimin e atësisë duhet të shpallet i papranueshëm.
81. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.
82. Prandaj dhe përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese sepse parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij, dhe rrjedhimisht e njëjta nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Në pajtueshmëri me arsyetimin e këtij aktvendimi, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si pasojë e (i) mos konstatimit të drejtë të gjendjes faktike në përcaktimin e detyrimit financiar të parashtruesit të kërkesës për alimentacionin refuzohen si qartazi të pabazuar në baza kushtetuese; ndërsa (ii) pretendimi për vërtetimin e atësisë ndaj fëmijës D. K., refuzohet si pretendim i papranueshëm në baza procedurale për shkak të mosshterimit formal dhe substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Moszbulimi i identitetit

83. Në fund, Gjykata fillimisht vë në pah se parashtruesi i kërkesës nuk ka parashtruar kërkesë për moszbulim të identitetit. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata i referohet rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili përcakton që [...] *Gjykata me shumicë votash autorizon mos-zbulimin e identitetit ose e jep atë pa një kërkesë nga një palë. Kur lejohet mos-zbulimi i identitetit nga Gjykata, pala duhet të identifikohet vetëm me initiale ose me shkurtesa apo me një shkronjë të vetme*".
84. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në shkresat e lëndës si dhe duke marrë për bazë ndjeshmërinë e rastit, vlerëson që me qëllim të mbrojtjes së identitetit të fëmijës së mitur D.K., moszbulimi i identitetit të parashtruesit të

kërkesës konsiderohet të jetë i domosdoshëm. Rrjedhimisht, Gjykata, parashtuesit të kërkesës në këtë aktvendim i është referuar me initiale. (Shih rastin e Gjykatës KI122/19, parashtues *F.M.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 9 korrikut 2020).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47. 2 të Ligjit dhe rregullat 32 (6), 39 (1) (b) dhe (2), si dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 10 dhjetor 2021, njëzëri


VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË MOS ZBULOJË identitetin e parashtuesit të kërkesës;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani

